



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 01.04.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (*titulli i projektvendimit*): **PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E NDËRMARRJEVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË DURRËS.**

Baza ligjore:

Ligji Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi, Vendimit nr.328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.503 datë 1.8.2024 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.103 datë 11.2.2026”.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (*Çfarë propozohet në projektvendim*):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Grupi për Menaxhimin Strategjik, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës , sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr.7, nr.8, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e raportit.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1 janar 2026 dhe do të përballohen nga fondi rezervë për rritjen e pagave i alokuar nga buxheti i shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026, si dhe nga fondi rezervë i parashikuar në buxhetin e vitit 2026.
3. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 95 datë 28.10.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës” shfuqizohet.

4. Në pikën 2.6 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028", togfjalëshi "...me pagë bruto mujore 45000 lekë.." zëvendësohet me togfjalëshin "...me pagë bruto mujore 55000 lekë..".
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit, Qendra Kulturore "Aleksandër Moisiu", Biblioteka, Klubi i Shumësporteve "Teuta", Klubi i Futbollit "Teuta", Qendra Ditore të Moshuarve, Qendra Ekonomike e Arsimit, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Ndërmarrja Komunale Plazh, Ndërmarrja Rruga, Agjensia e Parqeve Urbane.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fondi rezervë për rritjen e pagave i alokuar nga buxheti i shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026, si dhe nga fondi rezervë i parashikuar në buxhetin e vitit 2026.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Grupi për Menaxhimin Strategjik.

Impakti social/grupet që preken:

Punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 01.04.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 7 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Mbledhja rezultoi me pikën nr 7 të rendit të ditës dhe u pyet për përmbajtjen për pagat: ose pyetja.
Pika nr 7 ka të bëjë me vlerën në këshillin bashkiak dhe me ardhurat e parashikuara në mbledhje.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar	Rolant Xhelilaj	Zv. Denis Lika Pro <u>Denis</u>
Zv/Kryetar	Erzen Laçi	
Sekretar	Hekuran Markola	PRO Markola
Anëtar	Jonada Mamo	PRO Mamo
Anëtar	Alfred Mullaraj	PRO Mullaraj
Anëtar	Kastriot Xhongoli	PRO Xhongoli
Anëtar	Silvana Agasi	PRO Agasi
Anëtar	Dritan Burgija	
Anëtar	Jonuz Myshketa	
Anëtar	Xhojana Gjineci	
Anëtar	Kontjana Kuçi	Kuçi